




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.4 Regjistri Themeltar
Dt.22.07.2024 Regjistrimi



VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: **Blerona HASA** (Relatore)
Gjyqtare: **Edlira PETRI** (Anëtare)
Gjyqtare: **Manjola XHAXHO** (Anëtare)
Gjyqtare: **Marsela DERVISHI** (Anëtare)
Gjyqtar: **Sokol IBI** (Anëtar)

me sekretare gjyqësore Antonela Prendi, sot më datë 24.07.2024, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen Nr.4 Akti Dt.22.07.2024, me:

PADITËS: Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar nga Z.Eridian Salianji.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Znj.Madalena Koja dhe Z.Blendi Kodra.

PERSONA TË INTERESUAR: Subjektet zgjedhore¹:

- Partia Republikane Shqiptare;
- Partia Demokristiane e Shqipërisë;
- Fryma e Re Demokratike;
- Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut;
- Partia e Lirisë;
- Partia Balli Kombëtar;
- Partia Demokratike;
- Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë;
- Balli Kombëtar Demokrat;
- Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar.

OBJEKTI: - Kundërshtim ndaj mosmarrjes vendim nga Komisioni Regullator në KOZ, "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024".
- Gjykimin e çështjes në themel nga ana e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe miratimin nga ana e Kolegjit të disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, sipas projektvendimit të

¹ Thirrur kryesisht me vendim të Kolegjit.

propozuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në mbledhjen e Komisionit Rregullator të datës 19.07.2024.

BAZA LIGJORE: Nenet 26, 145, 152, 153, 155, 156, 158, pika 1, shkronja "b" të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, zhvilluar në mungesë të personave të interesuar, pala paditëse dhe pala e paditur kërkuan pranimin e padisë, sipas objektit.

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

referuar pretendime dhe prapsimeve të palëve ndërgjyqëse dhe akteve provuese të dorëzuara në funksion të tyre:

VËREN

1. Presidenti i Republikës rezulton të ketë disponuar Dekretin Nr.244 Dt.05.07.2024, që konsiston në përcaktimin e datës 4 Gusht 2024, për zhvillimin e procesit të zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë.

2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet Njoftimit Dt.06.07.2024, rezulton të ketë propozuar thirrjen e Komisionit Rregullator.

3. Mbledhja e Komisionit Rregullator rezulton të jetë zhvilluar më datë 09.07.2024, me objekt: "Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024".

4. Komisioni Rregullator rezulton të ketë disponuar me vendim i cili, për shkak të mosmarrjes së katër votave², nuk është konsideruar i miratuar.

5. Në këto rrethana, mbi padinë e subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.3 Dt.17.07.2024, që konsiston në miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë.

6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet Njoftimit Dt.19.07.2024, rezulton të ketë propozuar sërish, thirrjen e Komisionit Rregullator, me qëllim miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë.

7. Mbledhja e Komisionit Rregullator rezulton të jetë zhvilluar më datë 19.07.2024, me objekt: "Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024".

8. Komisioni Rregullator rezulton të ketë disponuar me vendim i cili, edhe në këtë rast, për shkak të mosmarrjes së katër votave, nuk është konsideruar i miratuar.

9. Në këto rrethana, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, më datë 22.07.2024, rezulton të ketë investuar Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, me padi sipas objektit të pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit tonë, duke pretenduar se³:

² Neni 20/3 i Kodit Zgjedhor.

³ Qëndrim i konfirmuar edhe në seancë gjyqësore.

"Më datën 19.7.2024, ora 14.00 është njoftuar mbledhja e Komisionit Rregullator me këtë rend dite: "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të dates 4 Gusht 2024".

Ky projektvendim është përgatitur nga administrata e KQ.Z dhe i është propozuar Komisionit Rregullator nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në këtë projektvendim janë parashikuar disa karakteristika teknike të fletës së votimit që do të përdoret në zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë që do të zhvillohen në datën 4 gusht sipas dekretit të President nr.244, datë 5.7.2024, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë".

Gjatë shqyrtimit dhe diskutimit në parim të projektvendimit, nga ana e dy anëtarëve të Komisionit Rregullator, znj.Helga Vukaj dhe z.Muharrem Çakaj, janë ringritur të njëjtat pretendime lidhur me vendimin nr.69, datë 5.7.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z.Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023" si dhe lidhur me Dekretin e Presidentit nr.244, datë 5.7.2024, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë", të cilat janë trajtuar prej tyre edhe në mbledhjen e Komisionit Rregullator të datës 9.7.2024.

Dy anëtarët e sipërpërmendur të Komisionit Rregullator kanë theksuar në diskutimin në parim të projektaktit, faktin që, sipas tyre, jemi në të njëjtat kushte ligjore si edhe në shqyrtimin e projektaktit të mëparshëm, të propozuar për miratim në Komisionin Rregullator, atë që lidhej me miratimin e disa afateve procedural që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, të datës 4 gusht 2024.

Në vlerësimin e dy anëtarëve të Komisionit Rregullator, Vukaj dhe Çakaj, Vendimi nr.69 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është brenda afatit të ankimit dhe nuk i është nënshtruar ende verifikimit të ligjshmërisë së tij. Gjithashtu nuk kemi ende verifikimin e ligjshmërisë së Dekretit të Presidentit nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Kryetarja e Komisionit Rregullator, znj.Illirjana Nano, ripërsëriti qëndrimin e mbajtur në mbledhjen e datës 9 korrik 2024 të Komisionit Rregullator dhe theksoi se miratimi i këtij projektvendimi u hap rrugën proceseve të tjera të cilat konsistojnë në vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për përmbajtjen e fletës së votimit, pas regjistrimit të kandidatëve dhe hedhjes së shortit për renditjen e tyre në fletën e votimit.

Gjatë votimit në parim të projektvendimit, 3(tre) prej anëtarëve të Komisionit Rregullator kanë votuar pro dhe 2(dy) anëtarë kanë votuar kundër.

1.Në përputhje me nenin 20, pika 3 të Kodit Zgjedhor sipas të cilit "Aktet administrative të Rregullatorit në ushtrimin e detyrës janë vendimet. Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku katër anëtarë, përveç vendimeve sipas shkronjave "b" dhe "d" të pikës 2 të këtij neni, të cilat miratohen me shumicë të thjeshtë", ky projektvendim nuk mori shumicën e kërkuar nga Kodi për t'u konsideruar i miratuar.

Siç rezulton nga faktet e paraqitura më sipër, Komisioni Rregullator nuk ka marrë vendim për një çështje që është kompetencë e tij, duke vënë në rrezik proceset e domosdoshme ligjore para dhe për zhvillimin dhe administrimin e zgjedhjeve për Kryetar, në Bashkinë Himarë.

Për sa më sipër, Partia Socialiste e Shqipërisë po paraqet këtë kërkesë padi me argumentat si më poshtë:

1. Miratimi i këtij projektvendimi është kompetencë e Komisionit Rregullator sipas nenit 20, pika 1, shkronja "a" të Kodit Zgjedhor i cili parashikon:

"Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ ose nga anëtarët e tij, për:

a. Rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje."

Gjithashtu sipas nenit 98 pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar:

"Fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letrë, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e letrës në pjesën e pasme

të saj, si dhe të përmbajë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KOZ-së. Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikuese që nuk lexohen më si të lirë".

Në ushtrim të kësaj kompetence, Komisioni Rregullator ka miratuar edhe më herët të njëjtin lloj vendimi konkretisht:

- Vendim nr.14, datë 7.2.2022 "Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen me datë 6 mars 2022".

- Vendim nr.31, datë 29.8.2023 "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 shtator 2023".

Sipas relacionit bashkëshoqërues të projektvendimit: "Karakteristikat teknike të propozuara në këtë projektvendim janë të njëjta me ato të miratuara me vendimin nr.31, datë 29.8.2023, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023".

Ne kushtet kur, Komisioni Rregullator nuk ka mundur të marrë vendimin sipas nenit 20, pika 3, te Kodit Zgjedhor, pa patur asnjë shkak ligjor, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kodit Zgjedhor, në të cilin parashikohet:

Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KOZ-ja".

Si dhe në mbështetje të nenit 158, pika 1, shkronja "b", të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit: " Në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos gjykimin e çështjes në themel...", Kolegji Zgjedhor duhet të vendosë gjykimin e çështjes në themel dhe miratimin nga ana e tij të disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024".

10. I padituri Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, konfirmoi verbalisht në seancë gjyqësore të njëjtat shkaqe të ngritura në padi.

ARSYETIMI I KOLEGJIT

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, në kuptim të Nenit 20/3 të Kodit Zgjedhor, aktet administrative bazë të Rregullatorit në ushtrimin e detyrës janë vendimet që merren, si rregull, kur pro tyre votojnë së paku katër anëtarë.

Përrjashtimisht, në kuptim të Nenit 20/1,b,d të Kodit Zgjedhor, ky rregull nuk zbatohet në rastin kur Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitur nga administrata e KOZ-së ose nga anëtarët e tij, për:

- rregullat dhe udhëzimet për njehsimin dhe përmirësimin e praktikave zgjedhore, si dhe për veprimtarinë e institucioneve publike në shërbim të zgjedhjeve;
- rregulloren e mbledhjeve të Rregullatorit dhe rregulloren e seancave të KAS-it.

Në rastin në shqyrtim, sikurse evidentuam edhe në pjesën përshkruese të vendimit, Rregullatorit rezulton t'i jetë përcjellë nga KOZ, Projektvendimi "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024", në përputhje me Pikën 1/a të Nenit 20 të Kodit Zgjedhor, sipas përmbajtjes së të cilit:

"1. Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KOZ-së ose nga anëtarët e tij, për:

a) rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje".

Rregullatori rezulton të ketë marrë në shqyrtim Projektvendimin "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024" i cili nuk ka marrë në votim, katër vota pro.

Pikërisht për këtë shkak, me të drejtë në përmbajtjen e Vendimit Nr.3 Dt.19.07.2024, në të cilin është pasqyruar vota pro e tre anëtarëve dhe vota kundër e dy prej tyre, rezulton të jetë evidentuar fakti se:

"Në zbatim të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, akti nuk mori numrin e kërkuar të votave për t'u konsideruar i miratuar".

Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se, nuk jemi në kushtet që të detyrojë Rregullatorin që të rivotojë projektvendimin, përse kohë rezulton ta ketë marrë tashmë në shqyrtim dhe t'ia ketë nënshtruar procedurës së votimit.

Vendimmarrjen lidhur me këtë projektvendim, pala paditëse ia kërkon në këto rrethana, Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Lidhur me legjitimitimin e palës paditëse, Kolegji i referohet Nenit 145 të të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

"Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimeve të KOZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi".

Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor çmon të nevojshme të evidentojë faktin se, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve⁴, ka disponuar:

- Vendimi Nr.110 Dt.23.07.2024, që konsiston në "Regjistrimin e partisë politike "Partia Socialiste e Shqipërisë", me kryetar z. Edi Rama, me shkronjat nistore "PS", si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024".
- Vendimin Nr.111 Dt.23.07.2024 që konsiston në "Regjistrimin e partisë politike "Partia Republikane Shqiptare", me kryetar z.Fatmir Mediu, me shkronjat nistore "PR", si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 04 Gusht 2024".
- Vendimin Nr.116 Dt.23.07.2024 që konsiston në "Regjistrimin e partisë politike "Partia Demokratiane e Shqipërisë", me kryetar z. Nard Ndoka, me shkronjat nistore "PDK", si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024".
- Vendimin Nr.115 Dt.23.07.2024 që konsiston në "Regjistrimin e partisë politike "Fryma e Re Demokratike", me kryetar z. Sali Shehu, me shkronjat nistore "FRD", si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024".
- Vendimin Nr.119 Dt.23.07.2024 që konsiston në "Regjistrimin e partisë politike "Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut", me kryetar z. Vangjel Dule, me shkronjat nistore "PBDNJ", si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024"

⁴ Sipas të dhënave të pasqyruara në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- *Vendimin Nr.114 Dt.23.07.2024 që konsiston në "Regjistrimin e partisë politike "Partia e Lirisë", me kryetar z. Ilir Metaj, me shkronjat nistore "PL", si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024".*
- *Vendimin Nr.120 Dt.23.07.2024 që konsiston në "Regjistrimin e partisë politike "Partia Balli Kombëtar", me kryetar z. Adriatik Alimadhi, me shkronjat nistore "PBK", si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024".*
- *Vendimin Nr.112 Dt.23.07.2024 që konsiston në "Regjistrimin e partisë politike "Partia Demokratike", me shkronjat nistore "PD", drejtuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, i përfaqësuar nga z. Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024".*
- *Vendimin Nr.118 Dt.23.07.2024 që konsiston në "Regjistrimin e partisë politike "Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë", me kryetar z. Agron Duka, me shkronjat nistore "PAA", si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 04 Gusht 2024".*
- *Vendimin Nr.117 Dt.23.07.2024 që konsiston në "Regjistrimin e partisë politike "Balli Kombëtar Demokrat", me kryetar z. Artur Roshi, me shkronjat nistore "PBKD", si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024".*
- *Vendimin Nr.113 Dt.23.07.2024 që konsiston në "Regjistrimin e partisë politike "Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar", me kryetar z. Ylber Valteri, me shkronjat nistore "PBD", si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024".*

Lidhur me kërkimet objekt padie, Kolegji i referohet Nenit 158 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

"1. Në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos:

- a) pushimin e gjykimit;*
- b) gjykimin e çështjes në themel; ose*
- c) detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim".*

Mbi këtë situatë faktike e ligjore, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson të qenurit tashmë, organi i vetëm procedural që duhet të zgjidhë mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

Lidhur me procesin e të provuarit, në gjykim u administruan:

- *Procesverbali Dt.19.07.2024 i mbledhjes së Komisionit Rregullator;*
- *Relacioni Dt.18.07.2015 i Projektvendimit "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024";*
- *Vendimi Nr.3 Dt.19.07.2024 i Komisionit Rregullator.*

Neni 97 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

"2. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zgjedhësi voton me dy fleta votimi me formë të njëjtë dhe me ngjyra të ndryshme, një për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e bashkisë.

3. Shfuqizuar.

3/1. Ngjyra e fletës në zgjedhjet e qeverisjes vendore është e njëjtë në të dyja anët e saj.

4. Sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2 përqind".

Më tej, sipas parashikimeve të Nenit 98:

1. Fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KOZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KOZ-së.

Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen me sy të lirë.

2. Fletët e votimit prodhohen në blloqe pa kundërfletë. Numri i serisë së bllokut të fletëve të votimit shënohet në dokumentin që shoqëron bllokun e ambalazhuar, sipas përcaktimeve të KOZ-së.

3. Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përmbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi".

Kolegji çmon të nevojshme të evidentojë faktin se, në relacionin e projektvendimit, përcaktohet se:

"Referuar nenit 98, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, është parashikuar kompetenca e KOZ-së për përgatitjen e fletëve të votimit, të cilat duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KOZ-së.

Në zbatim të dispozitës së sipërcituar, administrata e KOZ-së ka hartuar projektvendimin "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024".

I. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT.

Neni 97, pika 2, e Kodit Zgjedhor përcakton se, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zgjedhësi voton me dy fletë votimi me formë të njëjtë dhe me ngjyra të ndryshme, një për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e bashkisë.

Në kushtet kur zgjedhjet e pjesshme do të zhvillohen vetëm për Kryetarin e Bashkisë Himarë, edhe projektvendimi i referohet karakteristikave të fletës së votimit për Kryetarin e Bashkisë.

Pika 3/1 e këtij neni përcakton se ngjyra e fletës së votimit në zgjedhjet e qeverisjes vendore është e njëjtë në të dyja anët e saj.

Përveç elementeve të sigurisë së letrës, fleta e votimit do të përmbajë dhe disa elementë teknikë në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit si dhe elementë të tjerë identifikues që nuk lexohen me sy të lirë (barcode).

Elementët e sigurisë dhe elementët teknikë janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në lidhjen nr.1 që i bashkëlidhet projektvendimit.

Komisioni Rregullator nuk mund të shprehet në mënyrë shteruese për dimensionet e fletëve të votimit, e për këtë arsye propozohet që me këtë vendim të miratohen dimensionet minimale të tyre. Në tekstin e projektvendimit është përcaktuar se përmasat e fletës së votimit mund të ndryshohen, në varësi të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen në zgjedhje brenda afatit ligjor.

Karakteristikat teknike të propozuara në këtë projektvendim janë të njëjta me ato të miratuara me vendimin nr.31, datë 29.8.2023, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023".

Konkretisht, propozohen karakteristikat si vijon:

Lloji i letrës: Letër me thurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjine, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit: jo më e vogël se 210 mm.

Gjatësia e fletës së votimit: jo më e vogël se 297 mm.

Orientimi i fletës së votimit: Portret.
Specifikime të përgjithshme: Stema e Republikës, me ngjyra. Logo KOZ, me ngjyrë.
Ngjyra e fletës së votimit: kodi i ngjyrës: PANTONE 7401 U
Barkodi (elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve):
Numri serial: 7 shifra
Qarku: 2 shifra
Bashkia: 2 shifra
Zona e administrimit zgjedhor: 2 shifra
Numri i qendrës së votimit: 6 shifra dhe elementin ndarës "/" ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit
Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit: Zona Zgjedhore; Qendra e votimit".

Për sa më sipër, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i vlerëson të bazuara në dispozitat e Kodit Zgjedhor, karakteristikat teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, evidentuar në relacionin e KOZ-së.

Shpenzime gjyqësore lidhur me këtë çështje, nuk u kryen.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Nenin 158/1,b/3 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, unanimisht:

VENDOSI

- Pranimin e kërkespadsisë.
- Miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024, sipas Lidhjes Nr.1, që i bashkëlidhet Projektvendimit "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024", e cila bëhet pjesë integrale e këtij vendimi.
- Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin dhe publikimin e tij të menjëhershëm në faqen zyrtare të institucionit.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall sot në Tiranë, më 24 të Korrikut 2024.

GJYOTARE
Edlira PETRI

GJYOTARË
Manjola XHAXHO

GJYOTARE
Marsela DERVISHI

GJYOTAR
Sokol IBI

GJYOTARE
Blerona HASA



Disa karakteristika të fletës së votimit për kandidatët për Krvetar Bashkie për zgjedhjet e pjesshme për Krvetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024

Lloji i letres:

Letër me thurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjinë, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 210 mm

Gjatësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 297 mm

Orientimi i fletës së votimit:

Portret

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra.

Logo KQZ, me ngjyra.

Ngjyra e fletës së votimit: kodi i ngjyrës:

PANTONE 7401 U

Barkodi (elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve):

- Numri serial 7 shifra
- Qarku 2 shifra
- Bashkia 2 shifra
- Zona e administrimit zgjedhor 2 shifra
- Numri i qendrës së votimit 6 shifra dhe elementin ndarës "/" ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit

Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit

Zona Zgjedhore

Qendra e votimit



